



Qendra për Arsim e Kosovës  
Kosova Education Center

**KEC**

MONITORIMI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE KOMUNALE TË ARSIMIT  
NË PESË KOMUNA TË KOSOVËS  
(Raporti final)

Prishtinë, qershor 2010

## Hyrja

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në fillim të shtatorit të vitit 2009 ka filluar zbatimin e projektit 9-mujor “Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës”. Realizimi i këtij projekti filloi si iniciativë për të monitoruar menaxhimin e financave komunale të arsimit, sidomos me rastin e fillimit të procesit të decentralizimit, i cili kërkon që DKA-të të bartin te shkollat përgjegjësitë për planifikimin dhe shpenzimin e buxheteve të tyre. Përkundër vullnetit të mirë të disa DKA-ve për të realizuar këtë përgjegjësi ligjore, ato u ballafaquan me mungesë të kapaciteteve për të deleguar menaxhimin e financave te shkollat. Për të ndihmuar DKA-të dhe shkollat në harmonizimin e buxheteve komunale dhe shkollore, Banka Botërore ka filluar në vitin 2009 një projekt disa vjeçar për të rishikuar formulën e financimit të shkollave dhe bartjen e përgjegjësisë nga komuna në shkolla. Projekti në vitin 2009 ka përfshirë tri komuna: Istogun, Kaçanikun dhe Gjilanin, ndërsa në vitin 2010 ka filluar dhe në 10 komuna të tjera të Kosovës.

Pikërisht për të analizuar efektet që ka sjellë procesi i decentralizimit në arsim, e në veçanti shkallën e transparencës së DKA-ve, të cilat janë pjesë e programit për bartjen e përgjegjësisë të menaxhimit të financave në shkolla, KEC ka realizuar projektin “Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës”. Meqenëse projekti realizohej për herë të parë në Kosovë, u pa e mjaftueshme që të përfshihen 5 komuna të Kosovës: Istogu, Gjilani, Prishtina, Gjakova dhe Vushtrria. Një zgjedhje e tillë e komunave është bërë duke u bazuar në dinamikën e pjesëmarrjes së këtyre komunave në procesin e decentralizimit të financave në arsim. Kështu Istogu dhe Gjilani u përzgjedhën si komuna të cilat kishin një përvojë në procesin e decentralizimit, komunitat e Prishtinës dhe Gjakovës bëheshin gati për fillimin e procesit në janar të vitit 2010, ndërsa komuna e Vushtrrisë nuk ishte e paraparë të përfshihej në këtë proces gjatë vitit 2010. Një përfshirje e tillë e komunave ofronte mundësi të shumta për të shqyrtuar performancën e zyrtarëve të DKA-ve në këto komuna, si dhe për të krahasuar shkallën e transparencës së DKA-ve në komunat që kishin përvojë në procesin e decentralizimit, atyre që ndërkohë janë bërë pjesë e saj dhe e atyre që ende menaxhojnë buxhetin në mënyrë të centralizuar.

Për të realizuar monitorimin e menaxhimit të financave në 5 komuna, KEC aftësoi 15 monitorues, të cilët më vonë ndërmorën hulumtimin e perceptimit të palëve me interes në lidhje me transparencën e DKA-ve dhe shkollave me rastin e menaxhimit të financave në arsim, si dhe krijimin e një marrëdhënie të llogaridhënies dhe të mbikëqyrjes së punës së DKA-ve. Përmes aftësimit të monitoruesve për të mbikëqyrë punën e DKA-ve është synuar që të sigurohet një partneritet funksional në mes të administratës dhe qytetarëve me qëllim të rritjes së shkallës së transparencës në mes të vendimmarrësve dhe përfituesve.

### Trajnimi i monitoruesve dhe përgatitja e udhëzuesit praktik për monitorim

KEC në bashkëpunim me ekspertët dhe palët me interes ka përgatitur kornizën e monitorimit, në të cilën janë identifikuar fushat dhe treguesit e monitorimit. Kjo kornizë ka shërbyer si material bazë për hartimin e udhëzuesit praktik të monitorimit, i cili sqaron në mënyrë të detajuar aspektet e ndryshme të monitorimit, si dhe përmban instrumentet për monitorim.

Pas përgatitjes së materialeve për monitorim, KEC ka zgjedhur nga 3 përfaqësues në secilën nga 5 komuna e përzgjedhura për t'i përgatitur si monitorues. Kjo është bërë me qëllim që të ndërtohen kapacitetet brenda komunës për të bërë monitorime si në sferën e arsimit, ashtu edhe në segmentet e tjera të jetës shoqërore. Për t'u përgatitur si monitorues janë përzgjedhur trajnerë të programit Edukimi kundër korrupsionit, përfaqësues të shoqërisë civile, mësime dhënë, studentë të fakulteteve, etj. Ekipet e monitoruesve sipas komunave janë:

Komuna	Monitoruesit
Prishtina	1. Nehat Bllacaku, drejtor i NGO “Mileniumi i Ri” 2. Shefki Rusinovci, mësime dhënë në ShFMU “Z.Hajdini” 3. Betim Latifi, FShMN, Departamenti i Matematikës
Gjakova	1. Arta Kaqi, zyrtare në OJQ “FOGJ” 2. Shqipe Boshnjaku, bashkëpunëtoe në OJQ “CBDC” 3. Drenusha Mula, bashkëpunëtoe në OJQ “Jakova”
Gjilani	1. Fatmir Latifaj, drejtor në OJQ “Ne për fëmijët” 2. Afrim Sabedini, mësime dhënë në ShFMU “A.Ajeti” 3. Flon Rudaku, Fakultetit Ekonomik
Istogu	1. Luan Blakaj, FShMN, Departamenti i Gjeografisë 2. Ajshe Metaj, mësime dhënë në ShML “ 3. Zeqir Ibrahimaj, mësime dhënë në ShML “
Vushtrria	1. Ekrem Feka, mësime dhënë në ShFMU “A. Z. Çajupi” 2. Avni Gërguri, mësime dhënë në ShFMU “A. Z. Çajupi” 3. Donjeta Salihu, Fakulteti Ekonomik.

Të gjithë monitoruesit kanë marrë pjesë në 3 punëtori me temat:

- Korrupsioni – kuptimi, format e manifestimit dhe strategjitë për luftimin e tij,
- Financat qendrore dhe lokale – grumbullimi dhe shpenzimi me theks të veçantë në financat në arsim,
- Korniza e monitorimit – aspekte praktike të monitorimit.

Në këto punëtori është prezantuar informacion i rëndësishëm për format e paraqitjes së korrupsionit, për mënyrën e grumbullimit dhe shpërndarjes së financave qendrore e lokale, si dhe është prezantuar udhëzuesi praktik i monitorimit, i cili ka sqaruar mënyrën e realizimit të monitorimit në komuna. Monitoruesit gjatë punëtorive janë përgatitur që:

- të analizojnë shkallën e perceptimit të performancës dhe transparencës së zyrtarëve të DKA përmes shqyrtimit të pyetësorëve,
- të kontaktojnë përfaqësues të financave në DKA dhe drejtorët komunalë për të shqyrtuar buxhetet komunale të arsimit dhe dinamikën e shpenzimeve në krahasim me planifikimet,
- të intervistojnë personat përgjegjës për menaxhimin dhe vlerësimin e shpenzimeve komunale të arsimit.

Pas ngritjes së kapaciteteve të monitorimit ka filluar faza e dytë e aktiviteteve. Në këtë fazë janë përzgjedhur shkollat në të cilat do të shpërndahej pyetësi. Për të pasur një vlerësim sa më real të situatës është vendosur që në Prishtinë pyetësi të shpërndahej në 10 shkolla, ndërsa në qytetet e tjera në 6 shkolla, prej të cilave gjysma do të jenë shkolla urbane. Nga secila shkollë e përzgjedhur është kërkuar që pyetësi të plotësohej nga drejtori i shkollës, kryetari i këshillit të shkollës dhe të paktën 20% e mësimitdhënësve. Një gjë e tillë është bërë për të kuptuar shkallën e transparencës së DKA-ve nga palët e ndryshme të interesit. Shkollat në të cilat është realizuar hulumtimi janë:

Komunat	Shkollat		Numri i të anketuarve
Prishtina	1. Hoxhë Kadri Prishtina 2. Xhevdet Doda 3. Ilirija 4. Gjergj Fishta 5. Meto Bajraktari	6. Pjetër Bogdani 7. Filip Shiroka 8. Avni Rrustemi 9. Ali Kelmendi 10. Rilindja	95 të anketuar
Gjakova	1. Nexhmedin Nixha 2. Yll Morina 3. Zekerija Rexha	4. Ukshin Myftari 5. Gjergj Fishta 6. Qemajl Bakija	82 të anketuar
Gjilani	1. Marin Barleti 2. Rexhep Elmazi 3. Musa Zajmi	4. Abdullah Tahiri 5. Nazim Hikmet 6. Ibrahim Uruqi	87 të anketuar

Istogu	1. Mit'hat Frashëri 2. Martin Camaj 3. Hysni Zajmi	4. Bajram Curri 5. Trepça 6. Ismail Qemajli	93 të anketuar
Vushtrria	1. Lutfi Musiqi 2. Mustafë Venhari 3. Naim Frashëri 4. Emin Duraku	5. Shkolla e re 2 6. 28 Nëntori 7. Liria	98 të anketuar

Në Vushtrri është bërë ristrukturimi i shkollave “Mustafë Venhari” dhe “Naim Frashëri” në tri shkolla, prandaj monitorët kanë anketuar një shkollë më shumë. Në këtë mënyrë është arritur që edhe në Vushtrri të kemi numrin e përafërt të të anketuarve me komunat e tjera.

### **Analiza e pyetësorëve sipas përqindjeve**

Identifikimi i 4 fushave të monitorimit ka përcaktuar dhe strukturimin e pyetësorit në 4 pjesë. Pjesa e parë e pyetësorit ka përmbajtur pyetjet që kanë të bëjnë me legjislacionin dhe njohjen e tij. Pjesa e dytë e tij ka përmbajtur pyetjet rreth planifikimit të buxhetit dhe pjesëmarrjes së palëve me interes në planifikim. Pyetjet rreth të hyrave vetjake dhe menaxhimit të tyre kanë qenë në pjesën e tretë dhe në fund kanë qenë pyetjet rreth ekzekutimit të buxhetit. Në pjesën e tretë të pyetësorit është kërkuar të përgjigjen vetëm të anketuarit e shkollave që realizojnë të hyra vetjake.

Treguesit e monitorimit kanë ndihmuar në përpilimin e pyetjeve të caktuara. Për secilin tregues të fushës janë formular pyetjet e duhura. Në tërësi pyetësi ka pasur 27 pyetje. Më poshtë është dhënë analiza e përgjigjeve sipas fushave.

### **Fusha 1 – Legjislacioni**

Në përgjithësi, vërehet se ekziston një dallim i theksuar në njohjen e legjislacionit të të anketuarve të komunave të ndryshme, varësisht nga dinamika e përfshirjes së komunave në projektin e Bankës Botërore për decentralizim. Sipas pyetësorëve, del se në komunat të cilat kanë qenë të përfshira në procesin e decentralizimit, pra në Istog dhe në Gjiilan, 70% respektivisht 72% e të anketuarve kanë njohuri të plotë ose të pjesshme për legjislacionin. Në dy komunat që janë përfshirë më vonë, pra në Gjakovë dhe në Prishtinë 54% gjegjësisht 67% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa në komunën e Vushtrrisë vetëm 30%. Nga përgjigjet e fituara shihet se procesi i decentralizimit ka filluar të sensibilizojë drejtorët e shkollave dhe mësimmhënësit për nevojën e njohjes së ligjeve me qëllim të mbrojtjes së interesave dhe kryerjes së detyrave që dalin nga to.

Deri sa të gjithë drejtorët mendojnë se i njohin të paktën pjesërisht ligjet, vetëm 42.06% e tyre janë shprehur se i njohin plotësisht. Ndërsa, përgjigjet e mësimmhënësve për njohjen e ligjeve të paktën pjesërisht sipas komunave janë:

Istog	68,4 %
Gjilan	65,7 %
Prishtinë	65,7 %
Gjakovë	50,0 %
Vushtrri	30,1 %
Mesatarja	55.98 %

Mosnjohja e plotë e ligjeve nga ana e mbi 57% të drejtorëve dhe mosnjohja e ligjeve të paktën pjesërisht nga afër 44% e mësimdhënësve është vërtetë shqetësuese.

Në pyetjen rreth ndarjes së drejtë dhe transparente të buxhetit për shkollat nga ana e DKA-ve, përgjigjet janë shumë më pozitive në komunat të cilat janë përfshirë në procesin e decentralizimit. Kështu në komunat që kanë një përvojë në zbatimin e formulës së re të financimit të shkollave, 50% respektivisht 60% e drejtorëve pajtohen plotësisht se DKA bën ndarjen e drejtë dhe transparente të buxhetit, ndërsa në komunat e tjera shifrat ndryshojnë nga 25-50%. Rritjen e shkallës së transparencës në komunat që janë duke e zbatuar procesin e decentralizimit në arsim e vërtetojnë edhe përgjigjet e mësimdhënësve dhe të kryetarëve të këshillave të shkollave. Në komunat e Istogut dhe Gjilanit 40,5% respektivisht 51,9% e mësimdhënësve pajtohen plotësisht se ndarja e buxhetit nga ana e DKA-ve është e drejtë dhe transparente, ndërsa në komunat e tjera vetëm 9,4-33,3% e mësimdhënësve janë shprehur pozitivisht. Për ndarjen e drejtë dhe transparente të buxhetit nga ana e DKA-ve pajtohen plotësisht 60% respektivisht 75% e kryetarëve të këshillave të shkollave të Istogut dhe Gjilanit, ndërsa në komunat e tjera shifrat ndryshojnë nga 0-57,1%.

Nëse shqyrtohen përgjigjet e të gjithë të anketuarve në këtë pyetje, atëherë përqindjet e përgjigjeve sipas komunave, të cilët pajtohen të paktën pjesërisht me ndarjen e drejtë dhe transparente të buxhetit për shkolla nga ana e DKA-ve janë:

Istog	74,7 %
Gjilan	57,0 %
Prishtinë	59,8 %
Gjakovë	32,5 %
Vushtrri	33,3 %
Mesatarja	51,46 %

Në komunat e përfshira në projektin e decentralizimit ka një transparencë më të theksuar se në komunat e tjera, mirëpo përqindja e të anketuarve të komunave që zbatojnë formulën e re dhe që nuk pajtohen se ka të paktën transparencë të pjesshme është kritike. Sceptik me punën e DKA-ve janë 43% e të anketuarve në Gjilan dhe 25,3% e të atyre në Istog.

Me anën e pyetësorëve është synuar të kuptohet edhe shkalla e transparencës në administrimin e buxhetit të shkollës. Përgjigjet në këtë pyetje e konfirmojnë po ashtu ndryshimin e përqindjeve në tri nivele, varësisht nga dinamika e përfshirjes së komunave në procesin e decentralizimit. Në komunën e Istogut dhe të Gjilanit mbi 69,8% e të anketuarve pajtohen plotësisht se administrimi në shkolla bëhet si duhet, në komunën e Gjakovës dhe të Prishtinës shifrat janë 51,7% e 58,2%, ndërsa në Vushtrri vetëm 37,5% e të anketuarve. Edhe përgjigjet e mësimdhënësve rreth transparencës në administrimin e buxhetit janë të klasifikuara në tri nivele: në Istog dhe në Gjilan mbi 66,2% e mësimdhënësve pajtohen plotësisht me administrimin e drejtë të buxhetit nga ana e

shkollave, në Prishtinë dhe në Gjakovë nga 44,4% respektivisht 59,4%, ndërsa në Vushtri vetëm 28,4% e mësimdhënësve.

Nga analiza e përgjigjeve në këto pyetje arrijmë në përfundimin se decentralizimi e ndihmon menaxhimin e drejtë të financave dhe transparencën. Në komunat që kanë realizuar procesin e decentralizimit që nga fillimi, menaxhimi i drejtë i buxhetit të shkollës dhe shkalla e transparencës janë më të larta se në komunat e tjera. Mirëpo, nga përgjigjet e të anketuarve kuptohet edhe një dallim tjetër substancial. Në komunat të cilat janë bërë pjesë e procesit të decentralizimit në vitin 2010 ka një shifër relativisht të lartë të përqindjes së përgjigjeve pozitive në lidhje me menaxhimin e financave dhe shkallën e transparencës, në krahasim me komunë e Vushtrrisë, e cila ende s'është bërë pjesë e këtij procesi. Pra, decentralizimi ka ndikuar në sensibilizimin e komunitetit arsimor për proceset që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave.

## Fusha 2 – Planifikimi i buxhetit

Pyetjet rreth planifikimit të buxhetit kanë qenë të ndara në 2 kategori: në pjesën e parë janë renditur pyetjet që i janë adresuar pjesëmarrjes së palëve me interes në planifikimin e buxhetit të shkollës, ndërsa në pjesën e dytë përmes pyetjeve të caktuara është synuar të kuptohet se sa është i mjaftueshëm buxheti për të plotësuar nevojat e shkollës.

Duhet cekur se shkollat të cilat janë pjesë e procesit të decentralizimit duhet të përfshijnë këshillin e shkollës me rastin e planifikimit të buxhetit. Përqindjet e përgjigjeve të drejtorëve dhe kryetarëve të këshillave të këtyre shkollave, të cilët pajtohen plotësisht se këshilli i shkollës merrë pjesë në planifikim të buxhetit sipas komunave janë:

Komuna	Drejtorët	Kryetarë e KSh
Istog	83,3%	75 %
Gjilan	100%	40 %
Prishtinë	66,7%	57,1 %
Gjakovë	66,7%	16,7 %
Vushtri	25%	14,3 %
Mesatarja	68.34 %	40,62 %

Rezultatet e kësaj përgjigjeje tregojnë se këshilli i shkollës është më aktiv në komunat që janë përfshirë në procesin e decentralizimit. Përqindja e vogël e kryetarëve të këshillave të shkollave në komunën e Gjilanit mund të sqarohet me faktin se vetëm 50% e shkollave në Gjilan janë të përfshira në procesin e decentralizimit. Mirëpo është shqetësues dallimi i përqindjes së drejtorëve dhe kryetarëve të këshillave të shkollës.

Përqindja e madhe e pjesëmarrjes në planifikim të buxhetit të kryetarëve të këshillave të shkollave në Prishtinë mund të jetë rezultat i sensibilizimit më të madh dhe prezencës së programeve të ndryshme që ndihmojnë këshillat e shkollave. Shumë programe që zbatohen në Prishtinë fokusohen në konsolidimin e këshillave të shkollës dhe funksionalizimin e tyre të plotë.

Ndryshimi i dukshëm i përqindjeve në mes të përgjigjeve të drejtorëve dhe kryetarëve të këshillave të shkollave ndihmon të kuptojmë se drejtorët tashmë e dinë se kryetarët e këshillave të shkollës duhet të jenë të përfshirë me rastin e hartimit të buxhetit të shkollës,

por që një numër relativisht i madh i tyre nuk e zbatojnë këtë në praktikë. Një raport i tillë mund të ndryshohet përmes sensibilizimit të drejtorëve dhe këshillave të shkollës për përparësitë e planifikimit me pjesëmarrje të të gjitha palëve me interes.

Derisa në shkollat e anketuara të Gjilanit dhe të Istogut 58,7% respektivisht 74,7% e mësimitdhënësve pajtohen plotësisht se buxheti i shkollës është transparent për palët e interesit në shkollë, në Gjakovë dhe në Prishtinë kjo përqindje është 47,7% gjegjësisht 50%, ndërsa në Vushtrri vetëm 30,8% e mësimitdhënësve të anketuar. Ndërsa, sa i takon iniciativave për kursim nga ana e stafit të shkollës dhe nxënësve përsëri prijnë shkollat të cilat janë pjesë e procesit të decentralizimit që nga fillimi. Ky rezultat tregon se menaxhimi i buxhetit nga ana e shkollave shton iniciativën për kursim dhe përdorim efektiv të buxhetit.

Përfundimin e mësipërm e vërtetojnë dhe përgjigjet e mësimitdhënësve në kategorinë dytë të pyetjeve, e sidomos përgjigjet për iniciativat e shkollës për të sanuar prishjet me kohë. Kështu, në Gjilan dhe në Istog mbi 66,7% e mësimitdhënësve pajtohen plotësisht se prishjet sanohen me kohë, në Prishtinë dhe në Gjakovë shifrat janë mes 41-52%, ndërsa në Vushtrri vetëm 33,8%. Evitimi i prishjeve me kohë i kontribuon mbajtjes me rregull të procesit mësimor, si një kusht i domosdoshëm për sukses të përgjithshëm të nxënësve.

Në kuadër të kësaj kategorie të pyetjeve ka qenë edhe pyetja rreth sigurimit të transportit për fëmijët që udhëtojnë mbi 3.9 km. Janë shqetësuese rezultatet e përgjigjeve në të gjitha komunat. Përgjigjet e të anketuarve rreth sigurimit të transportit për fëmijët që udhëtojnë janë mes shifrave 11,1-33,7%. Kjo është shqetësuese, sepse mungesat e fëmijëve për shkak të mossigurimit të transportit mund të ndikojnë në suksesin përfundimtar të tyre. Meqenëse transporti i fëmijëve që udhëtojnë është kompetencë e komunës e rregulluar me ligj, atëherë duhet të mendohet për një aktivitet të shtuar të drejtorëve që të kërkojnë nga DKA-të sigurimin e transportit për nxënësit e shkollave që menaxhojnë.

Të gjithë të anketuarit pa dallim ankohen për buxhetin e pamjaftueshëm në përmbushjen e nevojave të shkollës.

### **Fusha 3 – Të hyrat vetjake**

Në pyetjet e kësaj fushe është kërkuar të përgjigjen vetëm të anketuarit e shkollave që realizojnë të hyra vetjake. Çështjet kryesore që janë adresuar në këtë fushë kanë qenë mundësia e shkollës që të menaxhojë vetë me të hyrat vetjake dhe transparenca në menaxhimin e tyre. Meqenëse këto pyetje tregojnë shumë për shkallën e transparencës në mes të DKA-ve dhe shkollave, si dhe shkollave dhe mësimitdhënësve, atëherë përqindjet e tyre do t'i paraqesim të plota.

Përgjigjet e drejtorëve dhe mësimitdhënësve rreth menaxhimit me të hyra vetjake sipas komunave janë (tabela 1):

Komuna	Drejtorët	Mësimdhënës
Istog	100 %	77,4 %
Gjilan	50 %	42,1 %
Prishtinë	100 %	55,3 %
Gjakovë	66,7%	14,3 %
Vushtrri	20 %	24,6 %
Mesatarja	67,34 %	42,74 %

Tabela 1

Komuna	Drejtorët	Mësimdhënës	Kryetarët e KSh
Istog	100 %	67,3 %	66,7 %
Gjilan	100 %	41,7 %	100 %
Prishtinë	100 %	47,4 %	50 %
Gjakovë	100 %	32,1 %	25 %
Vushtrri	20 %	35 %	25 %
Mesatarja	84 %	38,29 %	53,34 %

Tabela 2

Përveç Gjilanit dhe Vushtrrisë, në komunat e tjera ekziston një mospërputhje e madhe në mes të përgjigjeve të drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve rreth menaxhimit me të hyrat vetjake. Një gjë e tillë është vërtetë problem, sepse nëse drejtorët menaxhojnë vetë me të hyrat e gjeneruara në shkollë, atëherë pse për këtë nuk janë të njoftuar mësimdhënësit. Në anën tjetër, përkundër faktit se Gjilani është pjesë e procesit të decentralizimit që nga fillimi, vetëm 50% e drejtorëve janë shprehur se menaxhojnë vet me të hyra vetjake. Me siguri dhe në këtë rast ka ndikuar fakti se vetëm 50% e shkollave në Gjilan janë pjesë e procesit të decentralizimit. Mos përfshirja e të gjitha shkollave në procesin e decentralizimit në Gjilan, shkakton dallime edhe në menaxhimin e të hyrave vetjake nga ana e shkollave.

Ndryshe nga drejtorët e Vushtrrisë (20%), të gjithë drejtorët e anketuar të komunave të tjera shprehen se menaxhimi i të hyrave vetjake bëhet me transparencë të plotë, mirëpo kështu nuk mendojnë mësimdhënësit dhe kryetarët e këshillave të shkollave të anketuara (tabela 2).

Nga këto tabela arrijmë të kuptojmë se shkalla e transparencës në mes të DKA-ve dhe shkollave në njërin anë dhe e shkollave me mësimdhënësit e tyre nuk është në nivel. Përqindjet e fituara në pyetjet e mësipërme tregojnë nevojën për aktivizim dhe përkrahje të këshillave të shkollës me qëllim që përmes punës së tyre të rritet shkalla e transparencës e me këtë dhe shfrytëzimi efektiv i burimeve ekzistuese.

#### **Fusha 4 – Ekzekutimi i buxhetit**

Pothuajse të gjithë të anketuarit pa dallim pajtohen se mësimdhënësit paguhen me rregull dhe atë në bazë të kualifikimit dhe normës, mirëpo është për t'u brengosur fakti se 1/3 e të gjithë mësimdhënësve të anketuar nuk e dinë nëse mësimdhënësit paguhen për orët shtesë dhe 1/5 e tyre nuk e dinë nëse ndalet pagesa për orët që nuk mbahen. Nga analiza e përgjigjeve në këto pyetje arrihet në përfundimin se ky sistem nuk funksionon.

Njëra nga pikat e dobëta të sistemit të arsimit është edhe sigurimi me kohë i zëvendësimeve për rastet e pushimeve mjekësore. Vetëm 75,3% e mësimdhënësve të Istogut pajtohet plotësisht se zëvendësimet bëhen me kohë, ndërsa në Gjilan përkundër faktit se është pjesë e decentralizimit vetëm 52,1% e mësimdhënësve pajtohen plotësisht, në Prishtinë 52%, në Gjakovë 63,1%, ndërsa situata më e rënduar është në Vushtrri me

37%. Mungesa e zëvendësimeve me kohë e vështirëson jashtëzakonisht procesin mësimor dhe shpesh rezulton me mos mbajtjen e orëve.

Në pyetjet për transparencën e pasqyrave financiare (tabela 3) dhe shpenzimin e buxhetit sipas planifikimit (tabela 4) kemi marrë këto përgjigje sipas komunave:

Komuna	Drejtorët	Mësim-dhënës
Istog	66,7 %	69,3 %
Gjilan	80 %	56,9 %
Prishtinë	88,9 %	51,4 %
Gjakovë	100 %	53 %
Vushtrri	25 %	25 %
Mesatarja	72,12 %	51,12 %

Tabela 1

Komuna	Drejtorët	Mësim dhënës
Istog	83,3 %	75,3 %
Gjilan	100 %	65,8 %
Prishtinë	88,9 %	52,7 %
Gjakovë	83,3 %	56,1 %
Vushtrri	12,5 %	30,9 %
Mesatarja	73,6 %	56,16 %

Tabela 2

Edhe pse transparenca dhe llogaridhënia duket e përmirësuar në komunat që janë pjesë e procesit të decentralizimit që nga fillimi ose janë përfshirë në këtë proces ndërkohë, përsëri mbetet shumë për t'u bërë në mënyrë që menaxhimi i buxhetit të shkollës të bëhet në mënyrë të drejtë dhe të funksionojë bashkëpunimi i duhur në mes të DKA-ve, drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve.

### **Përmbledhja e informacioneve nga intervistat gjysmë të strukturuar**

Për të marrë më shumë informacion rreth menaxhimit të financave komunale të arsimit, si dhe për të qartësuar disa rezultate që kanë dalë nga pyetësorët, monitoruesit kanë realizuar intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të organeve të ndryshme, të cilët janë përgjegjës për planifikimin, menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit të arsimit në komunat e përzgjedhura. Në secilën komunë janë realizuar intervistat me:

- Drejtorin Komunal të Arsimit,
- Zyrтарin për financa në DKA,
- Dy drejtorë të shkollave,
- Kryetarin e këshillit të një shkolle,
- Kryetarin e këshillit të prindërve në nivel të komunës,
- Auditorin e brendshëm të komunës.

Për intervista janë zgjedhur drejtorë të shkollave të ndryshme nga ato në të cilat janë shpërndarë pyetësorët. Kjo është bërë me qëllim që informacioni të jetë më i plotë si rezultat i përfshirjes së një numri më të madh të tyre.

Intervistat kanë qenë gjysmë të strukturuar me qëllim që monitoruesit të bëjnë disa pyetje të njëjta, përgjigjet e të cilave do të mundësonin krahasimin e informacionit të fituar. Përveç pyetjeve të parapara në udhëzuesin praktik, monitoruesit kanë adresuar dhe pyetje të tjera, varësisht nga zhvillimi i intervistës apo nevoja për të qartësuar ndonjë rezultat të fituar nga pyetësi. Pyetjet në intervistat gjysmë të strukturuar kanë qenë të njëjta për të gjithë të intervistuarit, përveç në rastin e auditorit të brendshëm të komunës,

të cilit i janë adresuar pyetje të tjera, specifike për punë e tij. Pyetjet kanë qenë të ndara në 4 fusha, në harmoni me fushat e pyetësorit.

Edhe në intervista shihet dallimi i përgjigjeve rreth njohjes së legjislacionit nga e të intervistuarve, varësisht nga dinamika e përfshirjes së komunës në procesin e decentralizimit. Në komunën e Istogut jo vetëm zyrtarët, por edhe drejtorët e shkollave kanë numëruar disa ligje dhe rregullore që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave komunale si:

Ligjin për menaxhimin e financave publike, qarkoret buxhetore, rregulloren për formulën e re të financimit, si dhe rregulloret komunale. Në Gjilan ka drejtorë që pranojnë se janë pjesërisht të njoftuar me legjislacionin, por ka edhe të tillë që i kanë deleguar përgjegjësitë te stafi i tyre. Në komunën e Prishtinës dhe të Gjakovës, përveç zyrtarëve të

---

*Njohja e legjislacionit nuk është e nevojshme, sepse buxheti menaxhohet nga DKA.*

*Drejtor i shkollës në Vushtrri*

---

komunës që janë të njohur me legjislacionin, drejtorët përmendin vetëm rregulloren për formulën e re të financimit, ndërsa nga intervistat në Vushtrri shihet se mungojnë informacionet rreth legjislacionit duke u arsyetuar me faktin se kjo është përgjegjësi e DKA-së.

Problemi më i madh i të gjitha komunave, qëndron në zbatimin e legjislacionit dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me financat. Të gjithë pa dallim ankohen në Ligjin për menaxhimin e financave publike duke përmendur vështirësitë që shkaktohen me rastin e shfrytëzimit të mjeteve financiare si: procedurat e shumta administrative të cilat kërkojnë kohë, tenderimi me tri oferta, aspekti i vlerësimit të ofertave që i japin përparësi çmimit më të ulët gjë e cila shpesh ndikon në cilësinë e shërbimeve, kushtëzimi i shkollave që të furnizohen te furnitorët e paracaktuar, largësia e shkollave nga furnitorët, krijimi i monopolit në ofrimin e shërbimeve, etj.

---

*Procedurat e prokurimit paraqesin vështirësi, sepse ato janë të njëjta sikurse kur ka qenë buxheti i centralizuar.*

*Drejtor i DKA*

---

Po ashtu, të gjitha komunat kanë vështirësi në respektimin e kritereve:

- për krijimin e klasave,
- në angazhimin e psikologut, zyrtarit financiar, mjekut, personelit të nevojshëm teknik,
- për sigurimin e zëvendësimeve për rastet e pushimeve mjekësore dhe të lehonisë,
- për sigurimin e transportit për fëmijët që udhëtojnë,
- për plotësimin e nevojave për nxënësit me aftësi të kufizuara, etj.

Zyrtarët e arsimit të të gjitha komunave ankohen se buxheti është i pamjaftueshëm për të respektuar të gjitha rregulloret e aprovuara. Si pasojë e mungesës së buxhetit, zyrtarët e të gjitha komunave numërojnë të njëjtat probleme me të cilat ballafaqohen në rastin e krijimit të paraleleve, si: mungesën e hapësirës së nevojshme në qendrat urbane, respektimin e dëshirës së nxënësve për t'u shkolluar në shkollat urbane, si dhe nevojën për sigurimin e procesit mësimor në fshatrat e largëta ku numri i nxënësve është shumë i

vogël. Këta faktorë ndikojnë që në disa raste numri i nxënësve në klasa të tejkalojë numrin 35, e në shkollat e mesme të larta ky numër të shkojë deri në 45-55 nxënës për klasë.

Buxheti i pamjaftueshëm në shumë raste e bën të pamundur angazhimin e stafit të nevojshëm profesional dhe teknik, i cili do të siguronte një rregull dhe mbarëvajtje të procesit mësimor. Në shumë shkolla mungojnë psikologët, zyrtarët financiarë, mjekët edhe pse këto shkolla i përmbushin kriteret e caktuara me rregullore. Po ashtu mungesa e buxhetit i kufizon zyrtarët në sigurimin e transportit për nxënësit që udhëtojnë, si dhe për sigurimin e kushteve për nxënësit me aftësi të kufizuara.

Sa i takon zëvendësimeve në rastin e pushimeve mjekësore dhe të lehonisë, si problem përmenden procedurat e komplikua për realizimin e pagesave. Zyrtarët dhe drejtorët ankohen se në të shumtën e rasteve zëvendësimet bëhen me vonesë dhe në disa raste të pushimeve të shkurtra mjekësore problemi zgjidhet me mirëkuptimin e kolegëve brenda shkollës.

---

*Zëvendësimet për pushimet mjekësore bëhen me vështirësi për shkak të sistemit të pagesave, ato zakonisht paguhen me kontratë mbi veprën.*

*Drejtor i DKA*

---

Megjithatë, nga intervistat kuptohet se në Istog dhe në Gjilan ka më shumë iniciativa për respektimin e kriterëve të rregulloreve të ndryshme, qoftë në krijimin e klasave, në angazhimin e personelit profesional dhe teknik, në sigurimin e zëvendësimeve me kohë, si dhe në sigurimin e transportit për nxënësit që udhëtojnë.

Janë interesante përgjigjet e të intervistuarve në lidhje me ndarjen e drejtë dhe transparente të buxhetit nga ana e DKA-ve, si dhe administrimin e duhur të buxhetit nga ana e shkollës. Në Istog dhe në Gjilan vërehet se ekziston një shkallë më e lartë e transparencës në ndarjen e buxhetit dhe në administrimin e tij, në krahasim me komunat e tjera. Mungesa e transparencës dhe informacionit lidhur me ndarjen e buxhetit për shkolla në komunat e tjera kuptohet nga këto përgjigje:

---

*DKA nuk jep informacione për buxhetin e shkollës, përkundër kërkesave tona.*

*Drejtor i shkollës*

*Asnjëherë nuk na janë ofruar informacione për ndarjen e buxhetit, e as ndonjë dokument.*

*Kryetar i këshillit të shkollës*

---

Sa i takon planifikimit të buxhetit, drejtorët e shkollave të Istogut dhe të Gjilanit deklarojnë se janë të kujdesshëm të ftojnë këshillin e shkollës në planifikim të buxhetit. Në komunat e tjera që janë përfshirë më vonë në procesin e decentralizimit, drejtorët e shkollave e pranojnë se këshillave të shkollave ende nuk i është dhënë një mundësi e tillë. Përfshirja e këshillit të shkollës në planifikim ka rezultuar me iniciativa të shtuara për kursim, gjë e cila ka ndihmuar që shumë shkolla kursimet t'i investojnë në pajisjen e tyre me material të nevojshëm shpenzues.

---

*Prej se kemi filluar me formulën e re të financimit dhe decentralizimit të buxhetit, si nxënësit ashtu edhe mësimitdhënësit dhe punëtorët teknikë kanë interesim për kursim të materialeve sidomos atyre shpenzuese.*

*Drejtor i shkollës*

---

Ndërsa në komunat e tjera, drejtorët shprehen se kursimi është pjesë e vullnetit të mirë të personelit të shkollës. Ata përmendin raste të kursimit të rrymës, ujit, nxehjes, por pa qenë të informuar nëse ata që kanë kursyer janë shpërblyer me ndonjë investim shtesë.

Në komunat që janë të përfshira në procesin e decentralizimit, shkollat kanë mundësi që prioritetet e tyre t'i marrin parasysh me rastin e planifikimit të buxhetit. Po ashtu, mundësia e përdorimit të kursimeve u lejon shkollave furnizim më të mirë me materiale të nevojshme për procesin mësimor, sigurim të mjeteve të nevojshme mësimore, si dhe reagim më të shpejtë në evitimin e prishjeve në shkollë.

Në rastin e të hyrave vetjake, disa drejtori komunale arrijnë të shtojnë buxhetin për arsimin përmes bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, duke realizuar të hyra nga participimi i prindërve për kopshte, pagesa e konvikteve nga ana e nxënësve dhe studentëve, pagesat për dëftesa, për diploma dhe kopje të tyre, realizimin e mësimit joformal, mbajtjen e provimeve për të rritur, ofrimin e sallave të edukatës fizike, etj. Zakonisht donacionet përdoren për rregullimin e infrastrukturës, ndërsa burimet e tjera shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të ndryshme të institucioneve që zakonisht gjenerojnë të hyra vetjake. Të gjitha të hyrat vetjake janë mbledhur në DKA dhe pastaj janë tërhequr nga vet shkolla që i ka gjeneruar, përmes kodit të vet buxhetor. Shkollat të cilat kanë gjeneruar të hyra dhe nuk kanë qenë pjesë e procesit të decentralizimit kanë qenë të kufizuara në shpenzimin e këtyre mjeteve, ndërsa me fillimin e procesit të decentralizimit shkollat janë më të lira në planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetjake.

Të gjithë të anketuarit pa dallim pajtohen se mësimitdhënësit paguhen me rregull dhe atë në bazë të kualifikimit dhe normës. Orët shtesë paguhen vetëm në komunën e Istogut dhe të Prishtinës, ndërsa për mungesat e mësimitdhënëse bëhet ndalesa, nëse një gjë e tillë raportohet nga drejtori i shkollës. Në rastet më të shpeshta drejtorët së bashku me mësimitdhënësit mundohen të gjejnë zëvendësimet për mësimitdhënësit që mungojnë duke kërkuar mirëkuptimin e stafit dhe kolegëve.

Nga intervistat vërehet se shkollat të cilat janë pjesë e procesit të decentralizimit i mirëmbajnë pasqyrat financiare dhe i bëjnë ato transparente për këshillin e shkollës dhe palët e interesuara, ndërsa në komunat e tjera në buxhetin e shkollës nuk kanë qasje as drejtorët e shkollave.

Në shkollat e Istogut dhe të Gjilanit të cilat janë pjesë e decentralizimit që nga fillimi, shihet se ekziston një korrespondencë më e mirë në mes të planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit të shkollës. Në këto shkolla planifikimi i drejtë i buxhetit nga përfaqësuesit e shkollës ndihmon në shpenzimin e tij. Në komunat e tjera, zyrtarët e DKA-ve e pranojnë që kanë bërë ndryshime në buxhetin e shkollës, nëse ka pasur tejkalime të shpenzimeve nga ana e ndonjë shkolle. Edhe drejtorët e shkollave e tregojnë se ndonjëherë i kanë tejkualuar shpenzimet, por kjo ka ardhur si pasojë e mungesës së informacionit rreth buxhetit të shkollës. Ata e përmendin se në rastet e tilla DKA-ja iu ka dalë në ndihmë duke iu mbuluar shpenzimet.

Edhe në përgjigjet e auditorëve të brendshëm të komunave vërehen dallimet në dy nivele. Auditorët e komunave të përfshira në procesin e decentralizimit janë më bashkëpunues dhe më të hapur në dhënien e përgjigjeve në krahasim me auditorët e komunave të tjera, të cilët ose nuk kanë dhënë asnjë informacion me arsyetimin se raportet e auditimit nuk janë publikuar ende ose informatat e tyre kanë qenë të përgjithshme dhe të shkurtra. Të gjithë auditorët kanë treguar për vështirësitë dhe problemet që kanë hasur gjatë auditimit të shpenzimeve të bëra nga DKA-të.

Disa nga parregullsitë që ata i kanë identifikuar në lidhje me menaxhimin e financave të DKA-ve janë:

- shpenzime të paplanifikuara,
- tejkalim të shpenzimeve,
- realizim i shpenzimeve pa zotim paraprak të mjeteve financiare,
- realizim i shpenzimeve për shërbime dhe furnizim pa kërkesa paraprake për inicim të procedurave të prokurimit,
- furnizimet me mallra dhe shërbime me para të gatshme në vende të ndryshme me çmime të ndryshme,
- paqartësia e përgjegjësive në mes të zyrës së prokurimit dhe DKA-ve, etj.

Nga parregullsitë e identifikuara shihet se ka raste të keq menaxhimit të financave komunale të arsimit. Në kërkesën për identifikim të rasteve konkrete të keq menaxhimit, të gjithë auditorët hezitojnë të japin përgjigje. Propozimi i tyre është që të rishikohen raportet e publikuara të auditimit.

Auditorët e komunave të cilat janë përfshirë në procesin e decentralizimit të buxhetit në arsim nuk harrojnë të potencojnë faktin se në komunat e tyre ka përmirësime të dukshme në lidhje me menaxhimin e financave të DKA-së viteve të fundit. Një mundësi për të

---

*Nuk kemi pasqyra financiare, sepse ato nuk na ofrohen (as librat për mbajtjen e këtyre të dhënave).*

*Drejtor i shkollës*

*Nuk na janë ofruar asnjëherë pasqyrat financiare.*

*Kryetar i këshillit të shkollës*

---

përmirësuar situatën dhe më tutje është bashkëpunimi më i mirë në mes të zyrtarëve të DKA-ve, drejtorëve të shkollave dhe zyrtarëve të prokurimit. Të gjithë zyrtarët e DKA-ve dhe drejtorët e shkollave duhet të kuptojnë rolin e auditorëve të brendshëm, të shfrytëzojnë njohuritë dhe përvojën e tyre, si një mundësi për të përmirësuar performancën e tyre. Për një nevojë të tillë shprehet dhe një auditor i brendshëm:

---

*Menaxhmentet e shkollave, por edhe të drejtorive komunale kanë nevojë për t'u trajnuar në mënyrë që të kuptojnë më drejtë rolin, qëllimin dhe nevojën e funksionimit të një kontrolli të brendshëm nga vetë menaxhmentet gjegjëse."*

*Auditor i brendshëm i komunës*

---

Nga pyetësorët dhe intervistat kuptohet se procesi i decentralizimit ka sjellë këto përparësi:

- planifikimin më të mirë të buxhetit dhe shpenzimin e tij,
- marrjen parasysh të prioritete të shkollës me rastin e planifikimit,
- shtimin e iniciativave për kursim nga ana e stafit dhe nxënësve,
- furnizimin më të mirë të shkollave me material shpenzues,
- shtimin e efikasitet në kryerjen e shërbimeve,
- eliminimin e prishjeve me kohë,
- ngritjen e nivelit të përgjegjësi të drejtorët dhe stafi i shkollës,
- rritjen e transparencës në realizimin e shpenzimeve,
- bashkëpunimin e shtuar në mes të DKA-së, shkollës dhe këshillit të shkollës,
- rritjen e interesimit për të gjeneruar të hyra vetjake, të cilat do t'i përdorin për nevojat e shkollës së tyre, etj.

Mirëpo, përkundër përparësive, drejtorët e disa shkollave të komunave që zbatojnë formulën e re të financimit kanë përmendur se decentralizimi është bërë vetëm sipërfaqësor. Ata pohojnë se si rezultat i decentralizimit ata dinë buxhetin e shkollës së tyre, por që kompetencat për shpenzimin e buxhetit, përveç disa shpenzimeve të vogla – petty kesh në lartasin 100 Euro/muaj, janë ende në DKA. Disa drejtorë përmendin se decentralizimi vetëm ka shtuar dhe një hallkë në zinxhirin e vështirë të realizimit të shpenzimeve, sepse tash procedurat për prokurim nisin nga shkolla për të vazhduar rrugën në DKA e më tutje.

Drejtorët e shkollave dhe zyrtarët financiarë të komunave të komunave që zbatojnë formulën e re të financimit kanë përmendur edhe disa vështirësi që e përcjellin menaxhimin e buxhetit të shkollave të tyre. Problemet kryesore me të cilat ata ballafaqohen janë:

- aftësimi i pamjaftueshëm i drejtorëve dhe stafit të shkollës për të menaxhuar me sukses buxhetin,
- mungesa e një zyrtari financiar në shkollë,

- pamundësia për të bërë ndryshime në zërat buxhetorë (përveç ndonjë ndryshimi simbolik),
- kufizimi i kompetencave të tyre në realizimin e shpenzimeve (ende shumë shpenzime realizohen nga DKA-të si ngrohja, materialet shpenzuese dhe higjienike, etj.)
- procedurat ende të komplikuar për realizimin e shpenzimeve,
- kufizimet në blerjen e materialeve të ndryshme në pikat e caktuara (largësia e shkollave nga këto pika blerjeje, cilësia e mallit që ato ofrojnë në raport me çmimin),
- largësia e shkollës nga furnitorët e paracaktuar,
- pamundësia për të angazhuar staf profesional përkundër përmbushjes së kritereve sipas rregulloreve,
- mungesa e një mjeshtri apo kompanie kontraktuese për prishjet e vogla,
- mungesa e internetit për komunikim më të shpejtë, etj.

Një detyrë tjetër e monitoruesve ka qenë edhe analiza e të hyrave buxhetore dhe shpenzimet sipas kategorive. Pas disa përpjekjeve monitoruesit kanë arritur me vështirësi të kenë të paktën pasqyrën e planifikimit të buxhetit dhe të shpenzimeve për vitin 2009. Këto pasqyra janë të bashkëngjitura në aneksin 1.

Nga analiza e buxheteve të DKA-ve të komunave të përzgjedhura kuptojmë se në vitin 2009 DKA e Prishtinës e ka realizuar buxhetin 95.02%. Në komunë e Gjakovës në periudhën janar-tetor 2009, DKA e ka realizuar buxhetin 92.06%. Monitoruesit në Gjilan kanë arritur të sigurojnë planifikimin e buxhetit të DKA dhe shpenzimet deri më 25.11.2009. Nga pasqyra shihet se DKA në këtë komunë deri më 25 nëntor ka realizuar vetëm 75.03% të buxhetit të planifikuar për vitin 2009. Ndërsa nga pasqyra e buxhetit të DKA-së në Vushtrri kuptojmë se buxheti realizohet 99.93%, mirëpo është shqetësues fakti se në të njëjtën zyrë, monitoruesit kanë marrë të dhëna të ndryshme në muajin tetor dhe dhjetor.

Edhe pse të gjithë të anketuarit dhe të intervistuarit pohojnë se buxhetet e shkollave janë të pamjaftueshme, nga pasqyrat shihet se DKA-të megjithatë kanë suficit të mjeteve.

## **Rekomandimet**

Procesi i decentralizimit të arsimit ka rritur shkallën e transparencës në menaxhimin e buxhetit në shkolla, ka shtuar bashkëpunimin e drejtorëve me këshillin e shkollës, ka mobilizuar stafin dhe nxënësit për kursime në shkollë me qëllim të investimit të kursimeve në nevojat e shkollës. Përveç këtyre përparësive, nga monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në pesë komunat e Kosovës, mund të japim këto rekomandime:

1. të organizohen takime informative me drejtorë të shkollave dhe mësime për të kuptuar më mirë rregullativën ligjore,
2. të rishikohet Ligji për menaxhimin e financave publike, me qëllim të lehtësimit të procedurave të prokurimit,
3. të caktohen qartë përgjegjësitë e zyrtarëve të DKA-ve dhe zyrtarëve të prokurimit,
4. të realizohet decentralizimi i plotë i buxhetit në nivel shkolle,

5. të fuqizohen shkollat dhe të shtohen kompetencat e tyre në realizimin e shpenzimeve (ngrohja, materialet shpenzuese, materialet higjienike),
6. të sigurohet interneti për të gjitha shkollat e në veçanti për ato të cilat janë pjesë e procesit të decentralizimit,
7. të sensibilizohen këshillat e shkollës për të marrë pjesë në planifikimin e buxhetit, si dhe në takimet kur raportohet shpenzimi i tij,
8. të angazhohet një zyrtar për financa në shkollë, si dhe të trajnohen drejtorët dhe stafi për menaxhimin e financave,
9. të aftësohen administratorët për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e shkollës,
10. të aftësohen drejtorët për ndërmarrësi dhe gjenerim të të hyrave vetjake, sidomos në shkollat profesionale,
11. të aftësohen mësime dhënësit për planifikim me pjesëmarrje dhe hartim të projekteve që do të ndihmonin në shtimin e buxhetit të shkollës,
12. të sensibilizohen mësime dhënësit për të marrë pjesë në planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetjake me qëllim që të sigurohet plotësimi i nevojave të shkollës,
13. të motivohen mësime dhënësit, nxënësit, stafi menaxhues dhe teknik i shkollës për kursim me qëllim të investimit të kursimeve në përmbushjen e nevojave të shkollës,
14. të përkrahen iniciativat e drejtorëve për të siguruar transportin për nxënësit që udhëtojnë,
15. të aftësohen administratorët për menaxhim të drejtë të buxhetit dhe mbajtje të rregullt të pasqyrave financiare të shkollës,
16. të krijohet një bashkëpunim më i madh në mes të DKA-ve, drejtorëve dhe zyrave të prokurimit, etj.

## Planifikimi dhe shpenzimi i buxheteve të vitit 2009 sipas komunave

### Komuna e Gjakovës

Analiza e buxhetit për Komunën e Gjakovës të drejtorisë së Arsimit është e punuar prej Janarit deri në Tetor të vitit 2009. Për dy muajt e fundit nuk kemi të dhëna ngase ende nuk janë përpunuar të dhënat e fundit të vitit.

Buxheti i planifikuar për Komunën e Gjakovës në Drejtorinë e Arsimit për vitin 2009 është:

Pagat:	4,871,190.00 €
Mallra dhe shërbime:	519,485.00 €
Shpenzime komunale:	260,000.00 €
Shpenzimet kapitale:	274,727.00 €
<b>Totali:</b>	<b>5,925,402.00 €</b>

*Buxheti i planifikuar deri në muajin Tetor 2009 është:*

Pagat:	4,394,131.42 €
Shpenzimet (mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale)*:	779,485.00 €
Shpenzimet kapitale:	274,727.00 €
<b>Total:</b>	<b>5,448,343.42 €</b>

*Ndërsa buxheti i shpenzuara deri në fund të muajit Tetor 2009 është :*

Pagat:	4,064,295.84 €
Shpenzimet (mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale)*:	694,403.31 €
Shpenzimet kapitale:	257,515.56 €
<b>Total:</b>	<b>5,016,214.71 €</b>

*Nga të dhënat e mësipërme shprehur në përqindje del se deri në fund të muajit Tetor buxheti është shpenzuar:*

Pagat :	83.44%
Shpenzimet (mallrat dhe shërbime dhe shpenzime komunale)*:	89.08%
Shpenzime kapitale :	93.74%
<b>Totali</b>	<b>84.66%</b>

Në fund të kësaj analize nuk mund të themi që ka suficit apo deficit sepse nuk i kemi të dhënat përfundimtare. Gjatë takimit në muajin tetor me zyrtaren e financave në DKA, vërejtëm që mjetet e tepërta të një shkolle shfrytëzoheshin për plotësimin e nevojave të një shkolle tjetër të komunës, të cilat e kishin shpenzuar buxhetin (kishin mungesë të mjeteve).

\* Kategorinë mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale i kemi përmbledhur ngase e patëm të vështirë ti nxjerrim rezultatet e veçanta.

### Komuna e Vushtrrisë

	Pagat dhe shtesat	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet komunale	Shpenzimet kapitale
Planifikimi i buxhetit 2009	3.498.209.68 €	339.134.00 €	77.000.00 €	299.006.00 €
Shpenzimi i buxhetit 2009	3.495.796.19 €	338.608.45 €	76.996.13. €	298.866.52 €
Të pashlyera	0.00 €	472.00 €	0.00 €	42.50 €
Suficiti për 2009	2.413.49 €	53.55 €	3.87 €	96.98 €
Deficiti për 2009	0.00 €	0.00 €	0.00 €	0.00 €

Ja edhe një tabelë mbështetëse për planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit për arsim në komunën e Vushtrrisë për vitin 2009

	Pagat dhe shtesat	Mallra dhe shërbime	Shpenzimet komunale	Shpenzimet kapitale
Të dhënat nga kopja e marrë më 30.10.2009	3.498.603.68 €	339.134.00 €	77.000.00 €	300.312.00 €
Të dhënat nga kopja e marrë më 29.12.2009	3.498.209.68 €	339.134.00 €	77.000.00 €	299.006.00 €

Këto dy tabela janë marrë në të njëjtën zyre, mirëpo edhe në planifikime shihet se ka ndryshime edhe pse e para është marrë në tetor, ndërsa e dyta në dhjetor.

**Komuna e Gjilanit**

Viti - 2009

Nr. Punëtorëve – 2005

**PLANIFIKIMI**

Paga & mëditje – 622 611.36  
Mallra dhe shërbime – 865 968.00  
Shpenzime komunale – 160 000.00  
Subvencione – 50 000.00  
Shpenzime kapitale – 267898.00

TOTALI (E) – 7 569 978.36

SHPENZIMI (deri më 25.11.2009)

Paga & medijtje  
Mallra dhe shërbime  
Shpenzime komunale  
Subvencione  
Shpenzime kapitale

TOTALI (E) – 5 679 926.27

VËREJTJE: Shpenzimin e buxhetit për momentin në DKA-Gjilan nuk e kanë të ndarë nëpër kategori ekonomike.

Kuvendi Komunal- Prishtinë

DKA

Shërbimi financiar i DKA

### RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN 2009

Fondi burimor	Lloji i shpenzimeve	Mjetet e alokuara	Mjetet e shpenzuara	Mbetja	Realizimi në %
10	Pagat	<b>10.629.897,64</b>	<b>10.551.420,74</b>	<b>78.476,90</b>	<b>99,261734</b>

Fondi burimor	Lloji i shpenzimeve	Mjetet e alokuara	Mjetet e shpenzuara	Mbetja	Realizimi në %
10	Sh.komunale	<b>963.713,00</b>	<b>963.655,50</b>	<b>57,50</b>	<b>99,994033</b>

Fondi burimor	Lloji i shpenzimeve	Mjetet e alokuara	Mjetet e shpenzuara	Mbetja	Realizimi në %
10	M&Shërbime	675.847,80	666.967,99	8.879,81	
21		623.864,37	622.364,37	1.500,00	
22		606.763,53	566.186,43	40.577,10	
Gjithsej:		<b>1.906.475,70</b>	<b>1.855.518,79</b>	<b>50.956,91</b>	<b>97,327167</b>

Fondi burimor	Lloji i shpenzimeve	Mjetet e alokuara	Mjetet e shpenzuara	Mbetja	Realizimi në %
10	Inves.kapitale	199.951,65	199.903,30	48,35	
21		2.133.939,39	1.700.109,28	433.830,11	
22		2.222.872,98	1.926.429,58	296.443,40	
31		50.000,00		50.000,00	
<b>Janë alokuar:</b>		<b>4.606.764,02</b>	<b>3.826.442,16</b>	<b>730.273,51</b>	<b>83,061389</b>
<b>Janë planifikuar:</b>		<b>3.950.000,00</b>	<b>3.826.490,00</b>	<b>123.510,00</b>	<b>96,873165</b>

Fondi burimor	Lloji i shpenzimeve	Mjetet e alokuara	Mjetet e shpenzuara	Mbetja	Realizimi në %
21	Subvencione	<b>180.000,00</b>	<b>179.179,56</b>	<b>820,44</b>	<b>99,5442</b>

### REKAPITULIM

Gjithsej mjete financiare	18.286.850,36	17.376.216,75	860.585,26	95,020282
Mj.financ të planifikuara	17.630.086,34	17.376.265,10	253.821,24	98,56

Nga raporti financiar shifet se përqindja e shpenzimeve të mjeteve të alokuara është mjaft e këaqshme kur dihet se shërbimi ynë ballafaqohet me mungesën e kushteve elementare për punë në aspektin hapsinor, organizativ, kadrovik etj

		656.764,02		
		17.630.086,34		